
MATERIALE SHKENCORE DHE KUMTESA

MUSTAFË HAZIRI**ZHVILLIMET POLITIKE NË KOSOVË - GREVA
E MINATORËVE TË TREPÇËS NË STARI TËRG
(20-28 shkurt 1989)**

Greva e Minatorëve të Trepçës në Stari Tërg është një ndër ngjarjet më të rëndësishme në Historinë e re të Kosovës. Fundi i shek. XX ishte vazhdimësi e përpjekjeve të popullit të Kosovës për realizimin e të drejtave të tyre qytetare dhe kombëtare.

Duke shfrytëzuar literaturën dhe burimet arkivore, të cilat i kam pasur në dispozicion, në këtë punim, kam synuar për të trajtuar më hollësisht këtë ngjarje të rëndësishme historike.

Në këtë punim jam përpjekur që t'i përdor sa më me besnikëri burimet arkivore të botuara dhe të pabotuara, duke i kombinuar me referenca shkencore dhe publicistike.

Ngujimi i minatorëve të Trepçës në Stari Tërg, në thellësi të galerive që zbresin deri 1000 metra nëntokë, tregoi vendosmërinë e minatorëve shqiptarë kundër politikës së Beogradit që synonte rrënimin e pozitës kushtetuese dhe juridike të Kosovës të vendosur me Kushtetutën e vitit 1974.

Ishte e vështirë të veprohej në mënyrë kaq të organizuar në ish Federatën Jugosllave, aq më tepër në njerën nga krahinat e Serbisë, në ekspansion, e gatshme për të vepruar në dëm të interesave të popujve që përbënin Federatën. Pavarësisht nga forca që ushtronte Serbia ishte e pamundur që ngjarjet në Kosovë të mos ndikonin në shfaqjen e çështjes si problem politik jugosllav, duke vënë në pah rregullimin e brishtë të sistemit të brendshëm jugosllav.

Gjithashtu, në këtë punim jam munduar të evidentoj qëndrimin e Perëndimit ndaj Krizës Ballkanike, duke mos e kuptuar atë si problem qendror dhe serioz deri në vitet 90-të të shek. XX. Greva e minatorëve të Trepçës në Stari Tërg, 20-28 shkurt 1989, ishte një demonstrim i hapur për të gjitha problemet e grumbulluara dekada me radhë duke e injoruar

dhe duke mos respektuar të drejtat legjitime të popullit shqiptar, që ishte popullsi shumicë në Kosovë.

Vështrim i përgjithshëm mbi periudhën para grevës dhe fillimi i protestave të nëntorit 1988

Pavarësisht nga kriza që po fillonte të shfaqej në Jugosllavi, viti 1980 ishte paralajmëruar “si vit i stabilizimit ekonomik”. Pikërisht për këtë arsye në kontekst të kufizimeve buxhetore dhe të krizës ekonomike, më 11 mars 1981, filluan protestat e studentëve të Universitetit të Kosovës. Demonstratat morën përmasa të mëdha, dhe në to u shfaq parulla: “Kosova Republikë”, e cila shprehte mospranimin e varësisë së Kosovës nga Serbia.

Sipas shifrave zyrtare, në Kosovë, nga viti 1981 deri në vitin 1988, në polici u morën në pyetje 584.373 shqiptarë, për t’u hetuar apo për të përfunduar në burg. Demonstrimi i parë i nacionalizmit serb në mënyrë të hapur u bë me rastin e vdekjes së A. Rankoviçit* në vitin 1983. Në raportin e “Amnesty International” mbi Jugosllavinë, botuar në vitin 1985, thuhej se disa mijëra vetë ishin burgosur për arsye të pastra politike, “krime për një fjalë goje”, nga të cilët ¾ ishin shqiptarë.

Demonstratat e vitit 1981, u përdorën si pretekst për ndërmarrjen represive të “diferencimeve”, të ndjekjeve masive të rinisë studentore e shkollore, të punëtorëve dhe të inteligjencies shqiptare. Njësi speciale të Serbisë dhe të ish Federatës Jugosllave u nisën drejt Kosovës. Në këtë situatë shumë shqiptarë u vranë, u torturuan dhe u burgosën¹.

Represioni i strukturave politike ndërkohë gjeti përkrahjen e Kishës Ortodokse Serbe, e cila deklaroi se ndjehej në “solidaritet me serbët e Kosovës dhe Metohisë”. Palë me strukturat politike të Serbisë u bënë edhe shumë intelektualë serbë. Idetë e tyre gjetën vend të sintetizuara në Memorandumin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë, ku frymëzues dhe nxitës ishte Dobrica Qosiç**.

* Aleksander Rankovic, ish ministër i Punëve të Brendshme të ish Jugosllavisë, i shkarkuar në vitin 1966 në Plenumin e Brionëve.

¹ Ana Lalaj, *Rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1948-1981*, Tiranë: Mësonjëtorja e parë, 2000, f. 149.

** Dobrica Qosiç, shkrimtar nationalist serb, ish anëtar i KQ të LKS, i shkarkuar në vitin 1969, për nacionalizëm. Formula e njohur e Qosiçit ishte se serbët në të kaluarën ishin fitimtarë në luftë dhe humbës në paqe.

Organizimi gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1988, i një varg “mitingjesh” në Serbi synonte paraqitjen e projektit politik, të Sllobodan Milosheviçit, “revolucionin antiburokratik”, që me demagogji të potenconte se uniteti politik i Serbisë ishte vënë në rrezik me federalizmin që rridhte nga Kushtetuta e vitit 1974. Nga korriku deri në tetor të vitit 1988, në tubime të tilla kishin marrë pjesë 3 milion serbë. Objektivi i vërtetë i Milosheviçit në gjithë këtë parapërgatitje, ishte, në radhë të parë, heqja e autonomisë së Kosovës. Ndërkohë u hap loja për të ndërhyrë në Kushtetutën e vitit 1974. Diskutime u zhvilluan edhe në Kombinatin “Trepça”. Propozime rreth amendamenteve të Kushtetutës së Kosovës deri në nëntor të vitit 1988, ishin konkrete. Punëtorët në tubime të ndryshme treguan pjekuri politike dhe sjellje të civilizuar. Ata ishin kategorikë kundër çdo përpjekje, që cenonte autonominë e Kosovës.

Gjithçka filloi në mëngjesin e 17 nëntorit të vitit 1988, kur minatorët e turnit të tretë të Stari Tërgut dolën nga miniera dhe u bashkuan në demonstratë me minatorët e turnit të parë. Minatorët shprehën revoltën kundër gjendjes politike në Kosovë. Në marshin protestues të minatorëve të cilët u nisën me këmbë për në Prishtinë, morën pjesë mijëra vetë. Me gjithë kërkesat e reduktuara të minatorëve të Trepçës, prapëseprapë pushteti antidemokratik i asaj kohe gjeti pretekstin që në Kosovë të ndërmernte arrestime, pushime nga puna dhe të largonte nga skena politike udhëheqësit shqiptarë, që kundërshtonin politikën serbe².

Është karakteristike se në këtë periudhë Ballkani ende nuk ishte në qendër të vëmendjes të vendeve demokratike të Evropës Perëndimore. Përqendrimi i vëmendjes së faktorit ndërkombëtar do të bëhej vetëm në fillim të viteve 90-të shek.XX. Kështu, deri atëherë asnjë ngjarje në Kosovë nuk ngjallte shumë interesim dhe nuk jepte shenja për solidaritet për shkak të rrezikimit të imazhit të Jugosllavisë, e cila më herët ishte vlerësuar në drejtim të mbajtjes së një “ekuilibri” midis amerikanëve dhe rusëve. Minatorët e Trepçës së Stari Tërgut, që më 17 nëntor 1988, u nisën në drejtim të Prishtinës, bënë rreth 52 km rrugë në këmbë për të shprehur vendosmërinë e tyre.

Tubimin minatorët e ndërprejnë rreth orës 22:00 dhe, po ashtu, në mënyrë të organizuar, u kthyen në vendbanimet e tyre³.

² *Historia e Popullit Shqiptar*, grup autorësh, vëll. IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj (1939-1990), Tiranë: Toena, 2008, f. 371.

³ Esat Stavileci, *Në mbrojtje të Pavarësisë së Kosovës*, Prishtinë: Prograf, 1998, f. 53.

Protesta të mëdha të minatorëve vazhduan edhe më 18 e 19 nëntor 1988 në Pallatin e Sporteve “Minatori” në Mitrovicë, duke i përsëritur gjithnjë kërkesat e tyre për ruajtjen e autonomisë së Kosovës etj. Protestuesve në Pallatin e Sporteve “Minatori” iu drejtua Azem Vllasi, anëtar i Kryesisë së KK të LKK-së. Ai u pajtua me kërkesat e minatorëve dhe theksoi se forcat politike në Kosovë nuk do të lejonin që me presion të bëheshin ndërrime të kuadrove e as të cenohej Kushtetuta e vitit 1974. Paraqitja e Azem Vllasit e qetësoi dukshëm situatën, duke menduar se forcat politike në Kosovë do të kenë forcë politike dhe profesionale për ta mbrojtur atë që ishte arritur⁴.

Tubimet vazhduan deri më 21 nëntor të vitit 1988. Kërkesat e minatorëve, në tërësi, kishin karakter politik. Për të mos provokuar pushtetin e atëhershëm, krahas flamurit kombëtar dhe atij të minatorëve, protestuesit bartnin edhe flamujt shtetërorë jugosllavë. Ata bartnin edhe fotografitë e Titos dhe parullat “*Rroftë KQ i LKJ-së*”, pastaj “*Rroftë LK i LKK-së!*”, “*Kushtetuta e vitit 1974*”, “*Azem Vllasi*”, “*Kaçusha Jashari*”*, “*Poshtë politika serbomadhe!*”, “*Kosova nuk është Vojvodinë!*”, “*Trepça punon, Beogradi ndërton!*” etj.

Në përkrahje të minatorëve në atë kohë dolën edhe 2000 studentë e nxënës shqiptarë, por ata u penguan nga policia për të mos iu bashkuar minatorëve. Ata kishin mbërritur në këmbë nga vise të ndryshme të Kosovës⁵.

Në mbrëmjen e 19 nëntorit të vitit 1988, në Radio-Televizionin e Prishtinës, u kumtua se në Prishtinë kanë arritur mbi 100.000 njerëz. Në qendër të qytetit dhe para ndërtesës së KK të LKK me këmbëngulje kërkohet realizimi i kërkesave të minatorëve.

Nga e gjithë kjo që po ndodhte, kuptohet se mjerisht energjia e akumuluar nga minatorët nuk u shfrytëzua si armë jashtëzakonisht e fortë për ta penguar Serbinë në fushatën e saj antishqiptare. Përkundrazi, u ndërmorën masa për amortizimin e kërkesave të artikuluar nga minatorët, madje disa “Marshin e Minatorëve” e quajtën marsh me karakter armiqësor⁶.

⁴ Aziz Abrashi, Burhan Kavaja, *Epojeja e minatorëve*, Prishtinë: Koha, 1996, f. 24.

* Figura të rëndësishme të elitës politike kosovare të kohës. Funkionarë kryesorë në KSA të Kosovës.

⁵ *Po aty*, f. 25-26.

⁶ A. Abrashi, B. Kavaja, *Epojeja e minatorëve...*, f. 30.

Kjo ishte akuza më e rëndë nga Beogradi ose njerëzit e tij në Kosovë që iu bë intelektualëve, minatorëve dhe të gjithë popullit shqiptar në përgjithësi, duke synuar që këto ngjarje të konsideroheshin me karakter armiqësor.

Greva e minatorëve të Trepçës më 20-28 shkurt 1989

Në rrethanat e agravimit negativ të situatës politike minatorët vendosën organizimin e grevës së përgjithshme si të vetmen alternativë për të mbrojtur arritjet kushtetuese të vitit 1974. Ajo filloi në minierën e Stari Tërgut. Minatorëve, tashmë nuk iu kishte mbetur rrugë tjetër. Strukturat shtetërore, duke mos u pajtuar me kërkesat e minatorëve, mendonin e provonin që t'i qetësonin minatorët duke fajësuar të tjerët⁷.

Greva filloi rreth orës 13:00, kur minatorëve të turnit "D" iu bashkuan minatorët e turnit "A" dhe më vonë edhe ata të turnit "B e C", si dhe punëtorët e nëpunësit e shërbimit jashtë zgafellës*.

Grevën e filluan 441 minatorë (315 minatorë të turnit të parë dhe 140 të turnit të tretë). Duke marrë parasysh gjendjen e rëndë që ekzistonte në Kosovë, rolin kryesor edhe këtë herë e luajtën minatorët e Trepçës, të cilët u barrikaduan në thellësi të minierës dhe hynë në grevë urie të përgjithshme. Informatat e para për fillimin e grevës i dha drejtori teknik i minierës "Trepça" në Stari Tërg, Ibush Jonuzi. Me gjithë përgatitjet e bëra për akomodimin e grevistëve nëntokë, rreziku ishte shumë i madh. Miniera kishte 12 horizonte në thellësi të tokës deri në 1000 m. Gjithsesi minatorët ishin të vendosur të sakrifikonin duke iu përmbajtur parimit "Një për të gjithë dhe të gjithë për një".

Kërkesat e Minatorëve

Minatorët grevistë dhe udhëheqësit e tyre të grevës, paraqitën këto kërkesa autentike⁸:

1. *Garantimi i themeleve të Kushtetutës së vitit 1974;*
2. *Të mos shpallet regjistri i organizatorëve të tubimeve të Nëntorit, sepse të gjithë minatorët ishin organizatorë dhe në mesin e tyre nuk kishte liderë dhe organizatorë të veçantë;*

⁷ Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës (më tej: ASHAK), Fondi i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, kutia 111.

* Galerisë nëntokësore.

⁸ A. Abrashi, B. Kavaja, *Epojeja e minatorëve...*, f. 34-36.

3. *Të merren në përgjegjësi ata, të cilët e kanë hartuar propozimin e ligjit për pensionim të parakohshëm të punëtorëve të arsimit në Kosovë;*
4. *Të japin dorëheqje nga pozitat e tyre politikanët e cekur, si: Rrahman Morina, Husamedin Azemi dhe Ali Shukriu;*
5. *Të ndërpritet politika e gabuar ndaj popullit shqiptar;*
6. *Menjëherë të vijnë në minierë Dr. Stipe Shuvar, Sllobodan Milosheviçi dhe Ali Shukriu (Minatorët kërkonin që këta politikanë t'iu flasin drejtpërdrejt për politikën diskriminuese ndaj shqiptarëve, së cilës ata po i kontribuonin shumë);*
7. *Nuk ka organizatorë të veçantë, por të gjithë jemi organizatorë;*
8. *Kërkojmë që fati i shqiptarëve në Jugosllavi të shtrohet në Kombet e Bashkuara;*
9. *Personat e panjohur në ato momente të mos hyjnë në zgafellë;*
10. *Të njoftohen përfaqësuesit e republikave dhe të krahinave për gjendjen në Kosovë.*

Vërehet se ndër kërkesat e minatorëve ishte edhe ajo me të cilën kërkohet internacionalizimi i çështjes së Kosovës, si dhe shqyrtimi i pozitës së shqiptarëve të Kosovës në OKB⁹. Gjithashtu kërkuan që mjetet e informimit serb të mos lejoheshin të hynin në zgafellë, sepse ishte krijuar bindja se gazetarët serbë gjithmonë kishin qenë e janë në funksion të politikës shoviniste.

Për minatorët e sëmurë në kuzhinën e minierës u ngrit spitali i improvizuar, ku mjekë e infermierë atdhetarë dhanë kontributin e tyre të pazëvendësueshëm. Idenë për këtë spital të improvizuar e dha dr. Skënder Boshnjaku, atëherë sekretar krahinor i shëndetësisë dhe i punëve sociale¹⁰.

Periudha e viteve 1981-1989, kishte qenë ndër dekadat më të vështira të historisë së Kosovës të periudhës së pas Plenumit të Brioneve të vitit 1966. Gjendjen e komplikoi më shumë iniciativa e Serbisë për ndryshimin e kushtetutës së RSFJ. Kështu, me kërkesën e Republikës së Serbisë dhe me propozimin e “reformatorit” Ante Markoviç, në kuvendin e Federatës (1989) u miratua i ashtuquajtimi programi jugosllav për Kosovën¹¹.

⁹ *Po aty*, f. 36.

¹⁰ A. Abrashi, B. Kavaja, *Epopeja e minatorëve...*, f. 89.

¹¹ Dashamir Uruçi, *Kosova dhe e drejta për vetëvendosje*, Shkodër: Shtjefni, 2001, f. 88.

Në këto rrethana, miratimi i 40 amendamenteve serbe më 23 shkurt 1989, në Kuvendin e Serbisë, pa miratimin e krahinave autonome, krijoi një situatë të ndezur. Qysh më herët kishin filluar përgatitjet psikologjike, duke organizuar mitingje të hapura të serbëve. E gjithë kjo kulmoi kur regjimi i Beogradit kishte filluar abrogimin e autonomisë së Kosovës¹².

Kërkesat e minatorëve të Trepçës të përpiluara në 10 pika, tri nga ato pika i kishin qenësore¹³.

1. *Garantimi i themeleve të kushtetutës së vitit 1974;*
2. *Dhënia e dorëheqjes së udhëheqësve të apostrofuar;*
3. *Marrja e masave ndaj të gjithë atyre që kanë hartuar projektligjin për pensionim të parakohshëm të punëtorëve të arsimit në Kosovë*¹⁴.

Kërkesa kryesore e minatorëve që të mos hiqet dorë nga parimet fundamentale të Kushtetutës së vitit 1974, tregon pjekurinë e minatorëve të Trepçës për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë në Kosovë. Megjithatë, më 23 mars të vitit 1989, kur u mbledh Kuvendi i Kosovës në rrethana të jashtëzakonshme, me një prani të madhe të pjesëtarëve të sigurimit shtetëror dhe të funksionarë të lartë të Serbisë, të cilët u përzier me delegatët brenda ndërtesës, u arrit të bëhen ndryshimet e programeve nga Serbia. Edhe pse pa 2/3 e votave, që ishin të domosdoshme, ndryshime kushtetuese u arrit të bëhen¹⁵.

Por gjendja ishte shumë alarmante dhe greva vazhdonte. Më 24 shkurt 1989 minatorët i vizitoi kryetari i Kryesisë së RSFJ-së, që vinte nga Bosnja e Hercegovina, Raif Dizdareviç. Në takim ai u shpreh se, po të kërkonin dorëheqjen e tij, do ta ofronte menjëherë. Më 25 shkurt në Stari Tërg erdhi edhe kryetari i kryesisë së KQ të LKJ-së, Stipe Shuvar*, por minatorët nuk pranuan të bisedojnë me të. Kështu, ai për rrjedhat e

¹² A. Abrashi, B. Kavaja, *Epopaja e minatorëve...*, f. 42. Duke arritur në minierën e Stantërgut, para se të zbrisnin, për të kontaktuar me grevistët, kishte ndodhur një duel i papritur ndërmjet Syrja Popovcit dhe Remzi Kolgecit. Për t'iu shpjeguar minatorëve se me ndryshimet e fundit janë bërë disa kompromise, që cenojnë themelet e Kushtetutës së vitit 1974, Remzi Kolgeci e pyeti: "Ju keni marrë pjesë si ekspert në Komisionin kushtetues", i tha "Pse i keni pranuar kompromiset?". Popovci iu përgjigj se "Kompromiset janë pranuar me insistimin e udhëheqjes politike të Kosovës!"

¹³ *Po aty*, f. 160-161.

¹⁴ Ibrahim Gashi, *Mitrovica gjatë periudhës 1946-1999* (Simpozium), Mitrovicë: 2010.

¹⁵ A. Abrashi, B. Kavaja, *Epopaja e minatorëve...*, f. 65-66.

* *Stipe Shuvar*, ishte kryetar i Kryesisë së Komitetit Qendror të LKJ nga Kroacia.

grevës u njoftua nga drejtuesit e Trepçës, Burhan Kavaja e Aziz Abrashi. Vizitat në fjalë nuk i qetësuan grevistët. Më 23 shkurt 1989, kryetari i Këshillit Ekzekutiv të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në ora 23:00, vizitoi minatorët i cili u shpreh se nëse kërkohet dorëheqja e tij do ta ofronte menjëherë.¹⁶ Autorja, Denisa Kostovicova në një studim të saj shkruan: “*Nacionalizmi ekstrem serb me Milosheviqin në krye i bëri ata (minatorët) të reagojnë jo vetëm si punëtorë, por edhe si shqiptarë*”¹⁷.

Solidarizimi i opinionit të brendshëm dhe të jashtëm me minatorët

Apeli i 215 intelektualëve (21 shkurt 1989)

Menjëherë pas fillimit të grevës më 20 shkurt 1989, në mbështetje të grevistëve dhe në mbrojtje të kushtetutës së Kosovës, në redaksinë e “*Rilindjes*” arriti apeli i 215 intelektualëve kosovarë. Ata kërkonin mbrojtje institucionale dhe afirmim të pozitës kushtetuese të Kosovës mbi bazën e parimeve themelore të Kushtetutës të RSFJ-së. Ky apel i shkruar në gjuhën e arsyes dhe të urtësisë, drejtuar ditën e dytë të grevës së minatorëve të Stari Tërgut, Kuvendit të Serbisë dhe opinionit jugosllav, është një ndër dokumentet më të fuqishme të angazhimit të intelektualëve të Kosovës në mbrojtje të të drejtave të garantuara me kushtetutën e Jugosllavisë. Aty theksohet shprehimisht se Kosova nuk është pronë politike e nacionale e cilitdo nacionalitet të saj. Pushteti okupues jugosllav ndërmori masa ndaj nënshkruesve të apelit të 215 intelektualëve shqiptarë¹⁸. Në vitin 1989, shqiptarët mbanin 67.9% të fuqisë punëtore në minierën e Trepçës në Stari Tërg¹⁹.

Intelektualët nënshkrues të dokumentit kërkonin që mos t'i ndryshonin amendamentet, që kishin të bënin me raportet ndërmjet Serbisë dhe Krahinave autonome. Në këtë apel duke u mbështetur në legjislacionin jugosllav të kohës, referencë ishte Kushtetuta e RSFJ-së, e cila ishte legjitime dhe e “frymëzuar në vlerat e revolucionit socialist dhe

¹⁶ ASHAK, Fondi i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, kutia 148.

¹⁷ Serge Metais, *Histori e shqiptarëve*, Tiranë: 55, 2006, f. 353.

¹⁸ ASHAK, Fondi i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, kutia 42.

¹⁹ *Po aty*, Fondi: Minir Dushi, kutia nr. 5, Aneks 11.

të emancipimit social politik të gjitha kombeve dhe kombësive të Jugosllavisë së re dhe të klasës punëtore dhe inteligjencës shqiptare²⁰.

Pasi bisedat me Stipe Shuvarin nuk dhanë rezultatet e pritura, opinioni i brendshëm dhe i jashtëm filloi të reagojë në përkrahje të minatorëve grevistë. Kështu, kryetari i Kuvendit të Sllovenisë Ivan Poterç* ishte shprehur: “*Tragjedia në Trepçë është turpi ynë*”. Apeli i Shoqatës së Shkrimtarëve të Sllovenisë dhe të Kuvendit të Sllovenisë kishte këtë përmbajtje: “*Të mbrohet populli shqiptar dhe të miratohen kërkesat e minatorëve*”²¹.

Protesta e qytetarëve të Sllovenisë në Pallatin e Kulturës “Cankariev Dom”, më 27 shkurt 1989, dhe reagimi i Jozhe Skolps*, i cili ishte shprehur se “*Unë në krahërorin tim e kam vënë bexhin: “Kosova moja dzhela” (Kosova është shteti im)*, patën një jehonë të madhe. Peticioni i 245.000 nënshkrimeve kundër dhunës në Kosovë dhe protesta e 3000 punëtorëve shqiptarë në Lubjanë, dëshmonin se problemi i Kosovës nuk ishte i panjohur edhe në njësitë e tjera federale²².

Edhe intelektualët kroatë nuk heshtën karshi ngjarjeve në Kosovë. Dr. Sllobodan Lang, këshilltar i Presidentit të Kroacisë, mes tjerash, ishte shprehur: “Në horizontin e nëntë të gjithë e kemi humbur të drejtën e heshtjes”²³.

Përfundimi i grevës së minatorëve të Trepçës dhe pasojat

Në përfundim, mund të themi se greva e minatorëve të Trepçës në minierën e Stari Tërgut ishte një ngjarje madhore në historinë e re të Kosovës. Qëndrimi tetëditor i minatorëve në minierë e ashpërsoi gjendjen edhe ashtu të rëndë në Kosovë. Gjatë kësaj kohe u regjistruan mbi 1000 raste të intervenimeve të domosdoshme mjekësore ndër grevistët. Vendosmëria e minatorëve të Trepçës i detyroi disa funksionarë të lartë të Kosovës, ndjekës të politikës serbe, të japin dorëheqje²⁴. Në orët e pasdites, në ditën e tetë të grevës, arriti shkresa me ofrimin e dorëheqjeve

²⁰ Gazeta *Rilindja*, Prishtinë, 23 shkurt 1989, f. 6.

* Ivan Poterç, ishte kryetar i Kuvendit të Shqipërisë dhe përkrahës i minatorëve grevistë.

²¹ *Po aty*.

* Ishte kryetar i Kryesisë së Lidhjes së Rinisë Socialiste në Slloveni.

²² S. Metais, *Histori e shqiptarëve...*, f. 353.

²³ *Po aty*.

²⁴ A. Abrashi, B. Kavaja, *Epopeja e minatorëve...*, f. 123.

të parevokueshme të tre funksionarëve të tillë, Rrahman Morinës, Hysamedin Azemi dhe Ali Shukriut.

Minatorët, pas konsultimeve ndërmjet tyre, vendosën të dalin nga zgafella dhe këtë komunikatë ia prezantuan edhe mjeteve të informimit. Dalja filloi më 28 shkurt të vitit 1989, në orën 21.00. Ekipi mjekësor ishte i përgatitur të merrte masat e mbrojtjes shëndetësore për minatorët me rastin e daljes nga miniera. Meqë një pjesë e minatorëve ishte në gjendje të rëndë shëndetësore, u organizua shtrimi i tyre në spitalet e Mitrovicës e të Prishtinës.

Pavarësisht zhvillimit të ngjarjeve të mëvonshme, funksionarët e lartë serbë e jugosllavë ishin të vendosur ta shkelin vullnetin e popullit shumicë në Kosovë. Më 1 mars 1989, autoritetet drejtuese të Federatës shtuan masat e posaçme në Kosovë. U organizuan edhe kundërveprime mbi baza nacionale. Si kundërpërgjigje ndaj grevës së minatorëve shqiptarë, u organizuan protesta të minatorëve serbë në të cilat u kërkua dorëheqja e drejtuesve të Trepçës, Burhan Kavajës** dhe të Aziz Abrashit***. Pas arrestimit u dënuan edhe Lazër Krasniqi, Ibush Jonuzi, Mensur Fejza, Riza Musliu, Avdi Uka, Veli Osmani, Tahir Salihu, Jetish Bajrami, Ismail Nimani, Ramiz Kadriu, Mursel Haziri dhe Sinan Kurteshi, funksionarë këta të kombësisë shqiptare me detyra të ndryshme shtetërore e partiake. Në të njëjtën formë të shoqërimit policor ishte sjellë edhe Azem Vllasi nga Bjelina e Bosnjës dhe Hercegovinës, i cili kishte qenë në vizitë te miqtë e vet. Në orët e para të 3 marsit 1989, në objektet e Qendrës së Sigurimit Shtetëror në Mitrovicë, të arrestuarve u ishte komunikuar se “në emër të popullit” janë të burgosur. Të prangosur dhe të shoqëruar nga forca të mëdha policore, të gjithë u dërguan në hetuesi. Të pandehurve iu dorëzuan vendimet për paraburgim me arsyetimin se kishin kryer veprim kundërrevolucionar dhe kishin shkelur rregullat shoqërore, në vendimin për paraburgim të Aziz Abrashit shkruhej: “Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicën e Titos me shkresën PP. Nr. 23/89, me datë 02.03.1989, paraqiti kërkesën për hapjen e hetimeve kundër Aziz Abrashit për shkak të dyshimit se ka kryer vepër penale të cenimit kundërrevolucionar dhe të rregullave shoqërore. Nga neni 114 të ligjit penal të Jugosllavisë të pandehurit sipas nenit 139, AL 1 e Ligjit

** Burhan Kavaja, ishte drejtor në minierën e flotacionit Trepça, në kohën e Grevës së Minatorëve, në vitet 1988-1989.

*** Aziz Abrashi, ishte kryetar i Këshillit Drejtues në kombinatin Trepça në vitet 1988-1989.

Penal të Jugosllavisë me propozim të ndërmarrjes së masave për paraburgim nga neni 191²⁵.

Vendime me të njëjtin arsyetim iu dorëzuan edhe Azem Vllasit dhe Burhan Kavajës. Në burgun hetues në Mitrovicë. Ata u vendosën në qeli me dimensione me gjatësi 3,40 m, gjerësi 1,25. Qelia a dhoma e vetmisë kishte vetëm një dritare të vogël sa për të hyrë pak ajër. Më 4 mars 1989, të gjithë u dërguan te gjykatësi hetues, Avdi Dinaj, në prani të prokurorit publik të qarkut të Mitrovicës, Spasoje Zafiroviç. Atje i morën në pyetje në prani të mbrojtësit të tyre, avokatit Bajram Kelmendi²⁶.

Pas burgosjeve që pasuan, më 1 mars 1989, me vendimin e inspeksionit krahinor të minierave, të nënshkruar nga Milosh Janiç, u mbyll edhe miniera e Stari Tërgut. Janiç deklaroi se një vendim i tillë ishte marrë me urdhër të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës dhe të policisë. Më 4 mars 1989, u thirrën të gjithë udhëheqësit e Shërbimit inxhiniero-teknik për të bërë përgatitjet për rifillimin e punës në minierë.

Minatori, Mursel Haziri, në këtë takim deklaroi shprehimisht: *“Derisa nuk i lirojnë drejtorët tanë nga burgu, ne nuk do të fillojmë punën”*²⁷. Minatorët u larguan duke përsëritur thënien proverbiale: *“Një për të gjithë, të gjithë për një”*. Kështu, tentimi i parë për fillimin e punës dështoi.

Vala e re e grevës ndodhi më 14 mars 1989. Mbi 300 minatorë të tubuar në restorantin e minierës qëndruan katër ditë e katër net pa ngrënë. Kjo kundërvënie e re në fakt kishte karakterin e grevës së urisë. Grevistët kërkuan lirin nga burgu të drejtorëve të tyre dhe ishin të gatshëm të sakrifikojnë edhe veten për idealet e tyre. Atyre iu prezantua drejtori i posaemëruar, Qazim Shala, i cili i njoftoi se ai do të ishte epror a drejtor i tyre. Minatorët nuk e pranuan, duke iu drejtuar me këto fjalë: *“Për ne drejtor legjitim është Burhan Kavaja!”* dhe të indinjuar, ndërprejnë komunikimin me këtë drejtor të emëruar dhunshëm. Pas kësaj te grevistët erdhi Nazmi Mustafa, kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës, i cili u soll keq me minatorët. *“Ju po e shkatërroni LKJ-në e Titos, i akuzoi ai, dhe do të shihni se do të përgjigjeni për këtë”*²⁸. Regjimi kishte projektuar ushtrimin e dhunës për të shkuar drejt rrënimit

²⁵ A. Abrashi, B. Kavaja, *Epojeja e minatorëve...*, f. 129.

²⁶ Mustafë Haziri, *Greva e minatorëve të Trepçës në Stantërg (20-28 shkurt 1989)*, Lidhja e historianëve të Kosovës, Prishtinë: 2011, f. 51.

²⁷ *Po aty*, f. 52.

²⁸ *Po aty*.

të autonomisë së Kosovës. Minatorët ishin shfaqur si pengesë ndaj mbi ta goditja erdhi e shpejtë. Më 17 mars 1989, në orët e para të mëngjesit, njësitë speciale erdhën në restorantin e ndërmarrjes dhe me dhunë, duke i fyer, rrahur dhe maltretuar, i nxorën minatorët përjashta.

Greva e minatorëve vazhdoi përsëri më 26 mars 1989. Edhe pse udhëheqësit e dhunshëm i detyruan minatorët, të rikthehen në punë, rreth 28 prej tyre nuk pranuan. Kështu, greva vazhdoi deri në orën 13.00. Greva rifilloi përsëri më 31 korrik dhe zgjati deri më 2 gusht 1989. Minatorët e turnit "D" të minierës së Trepçës në Stari Tërg, rreth 240 minatorë, nuk deshën të zbresin në horizontin e minierës, duke marrë si pretekst vonesën e të ardhurave personale. Grevës iu bashkuan edhe turnet e tjera. Kjo grevë, sado që paraqiste kërkesa të karakterit social, në fakt kishte karakter politik²⁹. Me moton "*nuk do të ketë prodhim për regjimin serbomadh*", kjo grevë ishte vazhdimësi e kërkesave dhe grevave të mëparshme. Në vitin 1989, shqiptarët përbënin 67.9% të fuqisë punëtore në minierën e Trepçës dhe në vendet e tjera industriale në Mitrovicë, në Zveçan etj.³⁰

Greva e urisë për herë të tretë filloi më 27 tetor 1989. Në muajin prill, udhëheqja e dhunshme e minierës së Stari Tërgut, pasi ishte gjendje e jashtëzakonshme, i kërkoi me anë të thirrjeve të detyrueshme të fillojnë punën ata minatorë "*që janë të dëgjueshëm*" dhe lojalë ndaj regjimit serb. Minatorët në mënyrë të qetë vazhduan grevën. Kështu edhe prodhimi u ndërpre, plotësisht. Edhe thirrjeve të detyrueshme, në qershor të vitit 1989, ata nuk i qenë përgjigjur, megjithëse për këtë u dërguan në gjykatë për kundërvajtje dhe u dënuan me 30-60 ditë burg. Kështu, pothuajse 1240 punëtorë kishin kaluar nëpër dyert e gjykatave të instaluar serbe në Kosovë, po edhe nëpër duart e policisë serbe.

Ata që gjoja e filluan punën në qershor në fakt menjëherë filluan përgatitjet për organizimin e sërishëm të grevës së urisë në horizontet e minierës, e cila edhe ndodhi më 27 tetor 1989, rreth orës 13.00, kur ndërrimi parë i turnit "D" filloi grevën e urisë. Minatorët refuzuan të dalin nga horizontet e tyre (galeritë), deri sa të lirohen nga burgu drejtuesit dhe shokët e tyre.

Drejtori i dhunshëm i minierës në Stari Tërg, Qazim Shala, në mënyrë jo të ndershme arriti të nxjerrë vetëm disa minatorë nga miniera.

²⁹ A. Abrashi, B. Kavaja, *Epopeja e Minatorëve...*, f. 129.

³⁰ ASHAK, Fondi: Minir Dushi, kutia nr. 5, anex 11.

Grevën e vazhduan rreth 60 minatorë të tjerë. Kjo grevë u ndërpre me metoda të vrazhda të policisë. Në aktakuzën nr. 84/89, të cilën e ngriti më 25 gusht 1989, Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, nëpërmjet Spasojë Zafiroviqit, përveç tjerash, thuhej se “*në kundërshtim me kushtetutën e vendit, veprimtaria kundërrevolucionare dhe nacionaliste e seperatistëve shqiptarë në Jugosllavi kishte për qëllim programor rrënimin e vëllazërim-bashkimit dhe shkatërrimin e marrëdhënieve ndërnacionale, shkëputjen e Kosovës nga RSFJ, si dhe cenimin e integritetit territorial*”³¹. Gjykimi filloi më 30 tetor 1989, kur në Gjykatën e Qarkut ishte gjykatësi Ismet Emra, i cili ishte emëruar kryetar i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, në vend të Kapllan Barutit³².

Gjykimi ndaj Azem Vllasit, Aziz Abrashit, Burhan Kavajës, Lazër Krasniqit, Ibish Jonuzit, Mensur Fejzës, Riza Musliut, Ismajl Nimanit, Mursel Hazirit, Sinan Kurteshit, Ramiz Kadriut, Veli Osmanit, Avdi Ukës, Jetish Bajramit dhe Tahir Salihut filloi në orën 10.00.

Ky proces pati jehonë të madhe jo vetëm në Jugosllavi, por edhe jashtë vendit, sepse në mesin e të akuzuarve ishte edhe Azem Vllasi, nga të parët të rinj udhëheqës i LK të Kosovës dhe anëtar i KQ të LKJ-së. Procesi gjyqësor i Mitrovicës kundër minatorëve të Trepçës, u përgatit nën diktatin e Serbisë dhe të vasalëve të saj nga Kosova. Gjatë mbrojtjes së Azem Vllasit, Aziz Abrashit dhe Burhan Kavajës, në sallën e gjyqit morën pjesë edhe disa përfaqësues të ambasadave të shteteve perëndimore, Anglisë, Gjermanisë, Francës dhe Italisë me seli në Beograd³³.

Në fund Kolegji i të pestëve i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, në përbërje të Ismet Emrës, kryetar; Jusuf Misinit, Milutin Zubacit, Shaban

³¹ A. Abrashi, B. Kavaja, *Epopeja e minatorëve...*, f. 137-139.

³² *Po aty*, f. 141.

³³ *ASHAK*, Fondi: Minir Dushi, kutia nr. 5, aneks 11. Në Agjencionin Shtetëror të Arkivit të Kosovës, në fondin e LKJ-së, LKS-së dhe LKK-së nga 43 kutitë që i kam pasur në dispozicion për qëndrimin e forumeve partiake dhe shtetërore ndaj grevës së minatorëve, shumë pak flitet për minierën e Trepçës. Kjo gjë, ndoshta, është bërë për shkak të mungesës së argumenteve për t’u ballafaquar me kërkesat legjitime të minatorëve të Trepçës. Qëndrimi i organeve shtetërore dhe partiake kishte si synim kryesor diferencimet në universitet, në institucionet shkencore, si në Institutin Albanologjik, në Institutin e Historisë dhe ndaj atyre pak politikanëve, të cilët nuk pajtoheshin me qëndrimet partiake të LKJ-së të nivelit krahinor. Gjithashtu, në dispozicion kam pasur fondin e prof. dr. Minir Dushit, Dokumentet e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë etj.

Klinakut dhe Radovan Bozhoviqit, anëtarë, më 24 prill 1990, rrëzoi aktakuzën dhe liroi të 14 të akuzuarit e procesit të minatorëve, një proces ky i montuar politik.

Forcat e mëdha policore ishin përqendruar në Mitrovicë, gjatë zhvillimit të këtij gjykimi të cilat u penguan nga të afërmit e të akuzuarve dhe qytetarët që të afroreshin para dyerve të burgut. Në orën 10.00, gazetari i Radio Prishtinës, Musë Preniqi, e informoi opinionin për lirim të 14 të akuzuarve. Ky lajm më vonë u përhap anembanë Kosovës.

Por, Serbia do të vijonte të tregonte forcën ndaj shqiptarëve, paralelisht me masivizimin e autoriteteve federative që po projektonin shkëputjen nga Federata e falimentuar. Greva e minatorëve të Trepçës nxori në shesh brishtësinë e RSF Jugosllave por përcaktoi edhe radikalizimin e veprimeve të Serbisë për ta gjuhëzuar Kosovën dhe për ta kthyer në një koloni tipike të nënshtruar tërësisht. Minatorët shqiptarë dhe të punësuarit e tjerë shqiptarë në administratë, arsim, shëndetësi etj., dhe në ndërmarrjet prodhuese “vetadministruese” shpejt do ta gjenin veten të flakur në rrugë. Studiuesi dhe aktivisti i njohur britanik i të drejtave të njeriut Robert Myers është shprehur kështu disa vjet më vonë: “Kur vizitova për herë të parë Mitrovicën në vitin 1996, u ballafaqova me ndjenjën e trishtimit. Të gjithë minatorët shqiptarë ishin flakur nga puna pas protestave të vitit 1989”³⁴.

Konkluzione

Duke bërë këtë vështrim mbi Grevën e Minatorëve të Trepçës në Stari Tërg, konstatohet se ajo është ngjarja më reprezentative në historinë e Kosovës në gjysmën e dytë të viteve 80-të. Ajo ishte një promotore e lëvizjeve të ardhshme politike në Kosovë, dhe denoncim i hapur për të gjitha problemet e grumbulluara dekada me radhë në Kosovë. Këto ngjarje ndikuan në zhvillimet e mëvonshme politike në Kosovë, që determinuan krijimin e shtetit të pavarur në Kosovë, në të cilën miniera e Trepçës akoma edhe sot e kësaj dite është aseti më i rëndësishëm ekonomik në vend.

Megjithatë, duke u nisur nga perspektiva e atëhershme politike, nuk ka qenë e çuditshme që kërkesat të artikuloreshin në emër të revolucionit për të cilin kishin derdhur gjak së bashku shumë kombe për Jugosllavinë

³⁴ Miranda Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve, një histori e shkurtër*, Tiranë: Toena, 2008, f. 371.

socialiste e vetëqeverisje në të cilën kombet dhe kombësitë do të duhej të ishin të barabarta.

Greva e Minatorëve të Trepçës në Stari Tërg ishte faktori më i rëndësishëm i fillimit të proceseve të ndryshimeve në Kosovë. Greva e Minatorëve të Trepçës në planin e brendshëm në tërësi ndikoi në organizimin e jetës politike dhe në homogjenizimin kombëtar ndër shqiptarët, ndonëse në rrethana të ndërlikuara. Kurse në planin e jashtëm, greva ndikoi në sensibilizimin e çështjes së Kosovës në arenën ndër-kombëtare.

Greva e Minatorëve të Trepçës në Stari Tërg gjatë 20-28 shkurt 1989 është njëra ndër ngjarjet e rëndësishme në historinë e re të Kosovës.

Ajo ka ndikuar në opinionin e brendshëm dhe të jashtëm, duke vënë në pah dobësitë organizative të sistemit politik komunist jugosllav, i cili proklamohej si sistem liberalo-demokratik. Këtu u pa qartë mentaliteti ballkanik i strukturave udhëheqëse shtetërore, duke filluar nga politika e nivelit krahinor, republikan dhe federativ.

Nacionalizmi serb nuk ishte frenuar siç mendohej nga disa politikanë të asaj kohe, por ai ishte kanalizuar brenda idesë jugosllave. Strukturat politike dhe institucionale shtetërore, të Federatës doli se kishin rënë nën ndikimin e politikës antishqiptare, ku qëllimi i Serbisë për rrënimin e pozitës kushtetuese e juridike që Kosova e kishte gëzuar deri në atë kohë me Kushtetutën e vitit 1974, qe miratuar, qoftë edhe në heshtje.

Edhe pse, Serbia e arriti qëllimin me anë të forcës, çështja e Kosovës u evidentua si problem politik jugosllav, duke vënë në pah rregullimin e brishtë të sistemit të brendshëm të Federatës.

Padyshim mund të themi se Greva e Minatorëve të Trepçës ishte promotore e lëvizjeve të ardhshme politike në Kosovë. Ajo ishte fillimi a preludi i një periudhe të ndryshimeve të mëdha të raporteve politike, që do të finalizoheshin pas 10 vjetësh me largimin e forcave të Serbisë nga Kosova me vendosjen e administratës së Kombeve të Bashkuara, dhe së fundi me Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës dhe me vendosjen e një realiteti të ri demokratik në Kosovë.